

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5830
E enjte, 18 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Kryetarja e Kongresit Amerikan konfirmon përkrahjen për Kosovën

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", LISEN BASHKURTI | FAQE 4 - 5



Kosova dhe Shqipëria përballë sfidave të mëdha

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka bërë me dije se Kosova dhe Shqipëria gjenden përballë sfidave të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka ftuar lidhshimin e të dy vendeve të jenë të vëmendshme ndaj këtyre sidave. Bashkurti ka deklaruar se në veçanti

Kosova duhet të ketë kujdes në dialogun me Serbinë. Sipas tij, në këtë proces Kosova duhet ta respektojë kuadrin kushtetues, të veprojë në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm ndërinstitucional dhe të veprojë në bashkëpunim me partnerët strategjikë ndërkombëtarë. Diplomati shqiptar ka vlerësuar se institucionet e Kosovës nuk duhet të kenë frikë për të negociuar sikurse nuk duhet të negociojnë pa pasur frikë. Duke folur për situatën e fundit në Shqipëri, Bashkurti ka theksuar se Shqipëria është në krizë politike, institucionale, ekonomike dhe sociale

19 grupe kriminale janë shkatërruar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti

Policia e Kosovës ka arritur t'i shkatërrojë nëntëmbëdhjetë grupe të krimit të organizuar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Kështu ka deklaruar zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, të mërkurën në një konferencë për medie, në të cilën është prezantuar raporti i punës për periudhën janar-qershor të vitit 2019. Ai ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur rënie të kriminalitetit në vendin tonë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Mehmeti ka thënë se prioritetet e policisë vazhdojnë të mbesin ofrimi i sigurisë dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë si dhe parandalimi i krimit, korrupsionit dhe terrorizmit | FAQE 3



Ambasadori i Norvegjisë kërkon nga institucionet e Kosovës që ta luftojnë korrupsionin

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE



HOXHAJ THOTË SE DIALOGUT KOSOVË - SERBI I DUHET QARTËSI F. 6

MBI 16 000 ÇIFTE U KURORËZUAN NË VITIN 2018

F. 8

EDHE GJERMANIA DO TË BËHET ME OBJEKT TË RI TË AMBASADËS NË PRISHTINË F. 2

HARADINAJ E LIMAJ VIZITOJNË KOMUNËN E MALISHEVËS, NJOFTOHEN ME QEVERISJEN E BEGAJT F. 3

EKONOMI



MBI 10 MIJË NËNSHKRIME PËR HEQJEN E HOMOLOGIMIT, PETICIONI DORËZOHET NË KUVEND F. 9

MUZAFER SHALA EMËROHET MINISTËR I INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË F. 8

SPORT

REXHA: NË LIGËN E EVROPËS DO TË MARRIM REZULTATE MË TË MIRA F. 13

Edhe Gjermania do të bëhet me objekt të ri të Ambasadës në Prishtinë

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, dhe ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, kanë nënshkruar të mërkurën kontratën për shfrytëzimin e një prone të paluajtshme në Prishtinë për Ambasadën e Gjermanisë. Në vitet e ardhshme do të ndërtohet objekti i ri i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë. Objekti i Ambasadës së Gjermanisë do të ndërtohet afër QKUK-së. Pas ceremonisë së nënshkrimit të

kontratës, ambasadori Heldt është shprehur: "I gëzohem këtij hapi të parë të rëndësishëm për ndërtimin e objektit të ri të Ambasadës së Gjermanisë dhe falënderoj kryetarin e komunës dhe Kuvendin Komunal të qytetit të Prishtinës si dhe Qeverinë e Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme. Ndërtimi i objektit të ri të Ambasadës së Gjermanisë në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë është një hap i ri, veçanërisht domethënës, në raportet tona bilaterale. Objekti i ri

do të jetë një vend për takime dhe shkëmbime të hapura, të cilin edhe nga aspekti mjedisor dëshirojmë ta ndërtojmë në përputhje me standardet më të larta. Objekti i ri i ambasadës duhet të jetë shembull për urbanizëm miqësor dhe të gjelbër", ka thënë ambasadori Heldt. Ndërtimi i objektit të ri të Ambasadës së Gjermanisë do të planifikohet dhe kryhet gjatë viteve të ardhshme sipas standardeve më të larta gjermane dhe evropiane.



Kryetarja e Kongresit Amerikan konfirmon përkrahjen për Kosovën

Kryetarja e Kongresit Amerikan, Nancy Pelosi, i ka konfirmuar kryeparlamentarit Kadri Veseli përkrahjen e palëkundur amerikane për Kosovën dhe është zotuar se do të jetë gjithmonë në përkrahje të Kosovës e cila mund të llogarisë në ndihmën e saj dhe të Kongresit Amerikan



PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë vizitës që po zhvillon në ShBA, ka pasur një takim të veçantë me kryetaren e Kongresit Amerikan, Nancy Pelosi. Në këtë takim miqësor, kryetarja e Kongresit Amerikan i ka konfirmuar kryeparlamentarit Veseli përkrahjen e palëkundur amerikane për Kosovën. Ajo është zotuar se do të jetë gjithmonë në përkrahje të Kosovës dhe ka theksuar se Kosova mund të llogarisë në ndihmën e saj dhe të Kongresit Amerikan. "Amerika do të jetë përkrah Kosovës dhe do t'ju mbështesë gjithmonë", i tha Pelosi kryeparlamentarit Veseli. Nga ana e tij, kreu i Kuvendit të Kosovës e ka falënderuar kryetaren e Kongresit Amerikan për mbështetjen e pazërvë që ajo, Kongresi Amerikan dhe ShBA-ja i kanë dhënë Kosovës historikisht. Kryeparlamentari Veseli ka kërkuar nga kryetarja e Kongresit Amerikan që ShBA-

ja të ketë përfshirje edhe më të madhe dhe më të drejtpërdrejtë në proceset që po kalon Kosova. Gjatë këtij takimi, Veseli ka kërkuar nga Pelosi përkrahje të Kongresit dhe të institucioneve të ShBA-së për ushtrinë e Kosovës si dhe për iniciativën për dënimin e gjenocidit serb dhe krimeve e dhunimeve gjatë luftës në Kosovë. Kryeparlamentari Veseli e ka ftuar Pelosin që së shpejti ta vizitojë Kosovën. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në vazhdim e takimeve me personalitete të njohura të politikës amerikane, është pritur të mërkurën në një takim të veçantë nga kongresmeni Eliot Engel. Gjatë këtij takimi të ngrohtë dhe miqësor u diskutua për bashkëpunimin e ngushtë Kosovë - ShBA, për zhvillimet politike në vendin tonë, për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, për mbështetjen

amerikane në këtë proces dhe për perspektivën euroatlantike të shtetit të Kosovës. Veseli falënderoi kongresistin Engel për angazhimin e tij të gjatë prej disa dekadash në mbështetje të Kosovës dhe nëpërmjet tij, shtetin dhe popullin amerikan. Kongresisti Engel tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të jenë përkrah

Kosovës në të gjitha proceset që ajo ka para vetes. Engel tha se Bashkimi Evropian duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe të punojë bashkë me Kosovën në proceset eurointegruese. Ai, po ashtu, tha se Serbia duhet ta njohë shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Në këtë

takim, kryeparlamentari Veseli dhe kongresisti Engel folën edhe për nismën e kryeparlamentarit kosovar për dënimin e gjenocidit dhe krimeve që Serbia ka kryer në Kosovë. Engel tha se kriminelët duhet të përgjigjen para drejtësisë për të gjitha krimet që kanë kryer ndaj popullatës civile gjatë luftës në Kosovë.

Tahiri kërkon që shkeljet e të drejtave të njeriut të trajtohen me prioritet

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Holandës për të drejtat e njeriut, Mariet Schuurman, me të cilën ka diskutuar rreth mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ministri Tahiri e ka njoftuar ambasadorin Schuurman rreth reformave në sistemin e drejtësisë me qëllim të forcimit të të drejtave

fundamentale dhe parandalimit e luftimit të të gjitha formave të diskriminimit. Ai ka theksuar se është finalizuar Kodi Civil i cili reflekton frymën liberale të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa janë në proces edhe disa masa të tjera të cilat do t'i avancojnë dhe forcojnë të drejtat e njeriut. Ministri Tahiri ka bërë me dije se ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse që të gjitha rastet e shkel-

jeve të të drejtave të njeriut të trajtohen me prioritet si dhe është zotuar se do të mbetet i përkushtuar për zbatimin efektiv të legjislacionit. Ndërsa ambasadorja Schuurman ka thënë se është njoftuar me reformat e ndërmara në sistemin e drejtësisë dhe ka vlerësuar angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për përgatitjen e një numri të ligjeve që janë miratuar së fundmi.



Policia e Kosovës (PK) ka publikuar raportin gjashtëmuor (janar - qershor) të vitit 2019

19 grupe kriminale janë shkatërruar në gjashtëmuorin e parë të këtij viti

Policia e Kosovës ka arritur t'i shkatërrojë nëntëmbëdhjetë grupe të krimit të organizuar në gjashtëmuorin e parë të këtij viti. Kështu ka deklaruar zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, të mërkurën në një konferencë për medie, në të cilën është prezantuar raporti i punës për periudhën janar-qershor të vitit 2019. Ai ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur rënie të kriminalitetit në vendin tonë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Mehmeti ka thënë se prioritete të policisë vazhdojnë të mbesin ofrimi i sigurisë dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë, si dhe parandalimi i krimit, korrupsionit dhe terrorizmit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 KORRIK - Policia e Republikës së Kosovës të mërkurën në një konferencë për medie ka publikuar të gjeturat e raportit të punës për periudhën janar - qershor të këtij viti. Me këtë rast, zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka bërë me dije se në gjashtëmuorin e parë të këtij viti ka pasur rënie të kriminalitetit në vendin tonë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ai ka treguar se gjatë periudhës raportuese Policia e Kosovës ka arritur t'i shkatërrojë 19 grupe të krimit të organizuar. "Gjatë periudhës gjashtëmuore të këtij viti ka pasur rënie të veprave penale. Përderisa në gjashtëmuorin e parë të vitit

2019 kanë qenë 14 692 vepra penale, në periudhën e njëjtë të vitit 2018 kanë qenë 16 417 vepra penale. Në periudhën janar-qershor të vitit 2019 kanë qenë 12 vepra penale të vrasjes, kurse në vitin 2018 kanë qenë 16 sosh. Lëndime të rënda në vitin 2019 kanë qenë 129, ndërsa në vitin 2018 kanë qenë 138. Po ashtu, ka rënë edhe numri i grabitjeve për 23.30 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, në këtë periudhë Policia e Kosovës ka arritur të shkatërrojë 19 grupe të krimit të organizuar. Këta gjashtë muaj kemi pasur rënie të veprave penale", ka deklaruar Mehmeti. Ai ka treguar se gjatë periudhës raportuese janar - qershor Policia e Kosovës ka realizuar 505 operacione të specializuara, me ç'rast ka arrestuar

mbi një mijë persona për vepra të ndryshme kriminale. "Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 505 operacione të specializuara. I kemi realizuar 110 plane operative, 582 bastisje, 542 lokale të kontrolluara si dhe kemi arrestuar 1 047 persona. Po ashtu, janë ndaluar 333 persona si dhe ka pasur 930 kallëzime penale me kryes të njohur", është shprehur Mehmeti, duke shtuar se në gjashtëmuorin e parë të këtij viti ka pasur rritje të konfiskimit të substancave narkotike. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka deklaruar se shqetësues vazhdon të mbetet numri i aksidenteve me fatalitet në komunikacionin rrugor. Megjithatë, sipas tij, në periudhën raportuese ka pasur rënie të këtyre aksidenteve. "Komunikacioni rrugor

gjithashtu është një nga brengat e Policisë së Kosovës dhe gjatë viteve të fundit kemi pasur numër të madh të aksidenteve në trafik. Mirëpo edhe aksidentet në trafik gjatë kësaj periudhe gjashtëmuore për të cilën po flasim fatmirësisht kanë shënuar rënie ose trendi është në rënie. Nëse i shikojmë aksidentet me fatalitet gjatë kësaj periudhe kemi pasur 37 të tilla, kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 41. Edhe numri i personave të vdekur që neve na bën të shqetësohemi ka pësuar rënie nga 52 në 43", ka theksuar ai. Po ashtu, zëvendësdrejtori Mehmeti ka thënë se në raportin gjashtëmuor policia ka zbatuar 25 urdhra operativë si dhe ka asistuar në vizita të ndryshme. "Në 2 904 raste u kemi asistuar delegacioneve të

ndryshme, kemi përcjellë materie të rrezikshme dhe ka pasur asistime të ndryshme të cilat janë bërë jashtë punës së përditshme policore. Po ashtu, Policia e Kosovës ka marrë pjesë dhe ka reaguar edhe në 200 protesta. Gjithashtu, u kemi asistuar gjykatave në 1 805 raste", ka thënë Mehmeti. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se prioritet i policisë vazhdon të mbetet ofrimi i sigurisë dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë, si dhe parandalimi i krimit, korrupsionit dhe terrorizmit. "Objektivat e policisë kanë qenë ofrimi i sigurisë dhe bashkëpunimi me qytetar, parandalimi i krimit dhe korrupsionit si dhe parandalimi i terrorizmit", ka theksuar Mehmeti.

Haradinaj dhe Limaj vizitojnë Komunën e Malishevës, njoftohen me qeverisjen e Begajt

MALISHEVË, 17 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të mërkurën vizitë pune në Komunën e Malishevës, i pritur nga kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj, dhe i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. Kryeministri Haradinaj ka thënë me këtë rast se është mirë që janë aty për të diskutuar për tema të ndryshme dhe potencoi faktin se qeveria i ka qëndruar afër Komunës së Malishevës në disa tema. "Furnizimi me energji elektrike është problem, sepse mungon një transformator 110 kw", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se është një investim i përbashkët që do të ndodhë, me KOSTT-in dhe



mekanizmat e tjerë. Haradinaj i përmendi disa probleme, siç është diga e një

ujëmbledhësi, që kërkon të rinovohet, pastaj disa vendime të gjykatave që i çojnë në përm-

barim komunat e ua marrin paratë personelit në arsim, pra të gjitha këto tema, siç tha ai,

janë tema sfiduese që do të trajtohen bashkë në nivelin qendror. "Qeveria është kujdesur që t'u ndajë komunave tokë për kërkesa imediate, si rasti i varrezave, çerdheve dhe hapësirave të tjera të nevojshme publike", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, pasi falënderoi kryeministrin për vizitën, tha se kanë biseduar për shumë çështje me interes për këtë komunë, duke shprehur se do të realizohen shumë projekte për njerëzit aty. Pas vizitës në komunë, kryeministri Haradinaj vizitoi edhe kompaninë e dyerve dhe dritareve nga plastika dhe alumini "Ylli" në Malishevë, për të parë nga afër fushëveprimtarinë e saj dhe sfidat.

Flet për "Epokën e re", Lisen Bashkurti

Kosova dhe Shqipëria për

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka bërë me dije se Kosova dhe Shqipëria gjenden përballë sfidave të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka ftuar lidhshmërinë e të dy vendeve të jenë të vëmendshëm ndaj këtyre sfidave. Bashkurti ka deklaruar se në veçanti Kosova duhet të ketë kujdes në dialogun me Serbinë. Sipas tij, në këtë proces Kosova duhet ta respektojë kuadrin kushtetues, të veprojë në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm ndërinstitucional dhe të veprojë në bashkëpunim me partnerët strategjikë ndërkombëtarë. Diplomati shqiptar ka vlerësuar se institucionet e Kosovës nuk duhet të kenë frikë për të negociuar, sikurse nuk duhet të negociojnë pa pasur frikë. Duke folur për situatën e fundit në Shqipëri, Bashkurti ka theksuar se Shqipëria është në krizë politike, institucionale, ekonomike dhe sociale

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Bashkurti, procesi i dialogut Kosovë - Serbi është bllokuar. Si e shini vazhdimin e këtij procesi?

Bashkurti: Mënyra se si nisi dialogu Kosovë - Serbi, marrëveshjet që u firmosën midis palëve, qëndrimi i Serbisë për mosrespektimin e marrëveshjeve, mungesa e transparencës së negociatave në fazën e fundit dhe opsionet kontradiktore lidhur me ndarjen e Kosovës, ndryshimin e kufijve të saj, shkëmbimin e territoreve dhe problemet e krijuara në këtë kontekst, roli i paqartë që luajti përfaqësuesja e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, qëndrimet e ndryshme dhe në jo pak raste kontradiktore të aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë lidhur me këtë proces, në mënyrë të pashmangshme do të krijojnë një situatë bllokimi të negociatave. Bllokimi i negociatave është problem shumë serioz diplomatik. Bllokimi i bënë të gjitha palët të tërhiqen. Në teorinë dhe praktikën e negociatave thuhet se është më mirë të mos i nisësh negociatat sesa t'i nisësh dhe t'i bllokosh ato, sepse bllokimi i negociatave krijon shkallë të lartë mosbesimi midis palëve negociuese, por ndonjëherë edhe për palët e treta ose ndërmjetësuese. Bllokimi i negociatave nxitë, gjithashtu, edhe faktorët jashtë negociatorë për të ndërhyrë në proces ose për të reflektuar rreth tij, çka e komplikon më shumë negociimin dhe rritë gjasat për zgjatjen e bllokimit të tij për një kohë të gjatë dhe të paqartë.

Bllokimi i negociatave në shumë raste krijon efekte të paparashikueshme edhe në dinamikën në terren. Ai rrit tensionet politike, krijon kriza të ndryshme, provokon stabilitetin midis palëve, ndikon në qëndrueshmërinë e marrëdhënieve fqinjësore, përkeqëson bashkëpunimin rajonal si dhe ngadalëson deri në bllokim proceset integruese të të gjithë vendeve përreth krizës.

"Epoka e re": Ajo që ka nxitur dilema është propozimi i kryediplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles, për postin e shefit të diplomacisë së BE-së. Sa mund të ndikojë në rrjedhën e dialogut Kosovë - Serbi nëse ky proces do të drejtohet nga ky diplomat, vendi i të cilit është kundër pavarësisë së Kosovës?

Bashkurti: Emërimi i diplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles në krye të shërbimit të jashtëm të BE-së ka ngjallur skepticizëm në mjaft qarqe politike dhe diplomatike evropiane. Tek shqiptarët e Kosovës ky skepticizëm duket të jetë më i lartë. Unë i kuptoj arsyet historike, politike, mentale dhe psikologjike të shqiptarëve të Kosovës për këtë skepticizëm. Por, natyrisht, nuk i justifikoj ato. Lypset të kemi parasysh se Fontelles si diplomat i Spanjës dhe Fontelles si kryediplomat i BE-së kanë një ndryshim themelor. I pari përfaqësonte interesat kombëtare të Spanjës, politikën e jashtme dhe diplomacinë e saj, i dyti përfaqëson interesat e Bashkimit Evropian, politikën e jashtme dhe diplomacinë e organizatës. I pari përfaqësonte një shtet, Spanjën, i dyti përfaqëson njëzetetete shtete, pra BE-në. Midis politikës së jashtme dhe diplomacisë së Spanjës dhe politikës së jashtme dhe diplomacisë së BE-së ka dallime dhe ngjashmëri. Dallimet konsistojnë në dimensionin kombëtar spanjoll, ngjashmëritë në linjat e përbashkëta të BE-së. Kalimi nga diplomat nacional në diplomat i BE-së nuk lejon parimisht dhe praktikisht që të barten apo të transferohen politikat e diplomacia nacionale në nivele evropiane të BE-së. Diplomati i BE-së vepron nën flamurin e organizatës dhe në mbrojtje të linjave të politikës së jashtme dhe diplomacisë së saj. Ky proces është i rregulluar qartësisht në të drejtën ndërkombëtare, diplomatike dhe konsullore të OKB-së, e cila bën dallimin midis diplomatëve të shteteve nacionale dhe atyre të organizatave ndërkombëtare. Gjithashtu, Traktati i Lisbonës i BE-së, në kapitullin e tretë, për politikën e jashtme dhe të sigurisë, në artikujt për Veprimin e Shërbimit

të Jashtëm të BE-së (EEAS), përcakton qartë dallimin midis shërbimit të jashtëm të BE-së nga ai i shteteve individuale. Kryediplomati i BE-së udhëheq politikën e jashtme të BE-së dhe veprimin diplomatik të saj. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Natyrisht, kryediplomati i BE-së ka origjinën e vet, formimin dhe përvojën personale, lidhjet dhe ndikimet e ndryshme, që në një mënyrë apo tjetër, në një masë apo tjetër, nuk mund të anashkalohen e aq më pak të shpërfillen. Por, origjina, formimi dhe përvoja, lidhjet apo ndikimet personale të kryediplomatit të BE-së, nuk bënë që t'i cenonjë vlerat, parimet, normat dhe politikat e përbashkëta të BE-së. Një cenim sado i vogël që do t'i vendoste interesat e shteteve individuale mbi vlerat, parimet, normat dhe politikat e përbashkëta të BE-së do ta minonte gjithë organizatën në tërësi. Prandaj, mendoj se nuk ka vend për skepticizëm nga Kosova, sikundër nuk ka aspak vend për entuziazëm nga Serbia. Rasti i Mogherinit, që tentoi t'i hapte rrugë ndryshimit të kufijve Kosovë - Serbi, provon se devijimi sado i vogël individual i kryediplomatit të BE-së nga linjat e organizatës ndeshet në rezistencë të pakapërcyeshme të mbarë organizatës.

"Epoka e re": Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës që të dalin sa më mirë në këtë proces?

Bashkurti: Institucionet e Kosovës lypset të mbajnë parasysh se po hyjnë në një fazë shumë kritike të negociatave. Natyrisht nuk duhet pasur frikë për të negociuar. Por, gjithashtu, nuk duhet kursesi të negociohet pa pasur frikë. Negociatat janë betejë. Si çdo betejë, negociatat kanë tri alternativa: të fitohen, të humben ose të jenë kompromis, pra fitore pa të humbur. Unë do t'u sugjeroja institucioneve të Kosovës t'i kenë parasysh këto elemente: Së pari ta respektojë kuadrin kushtetues të saj. Kushtetuta e Kosovës është themeli juridik i shtetit të Kosovës, mbi të cilin Kosova u bë shtet i pavarur e sovran,

demokratik e shumetnik, me integritet territorial dhe aftësi për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kushtetuta e Kosovës u bazua në paketën e Marti Ahtisarit në fund të vitit 2007. Ajo përmban tri parimet themelore negociuese të arritura nga Grupi i Kontaktit për Kosovën, që ishin 'Kosova nuk ndahet, Kosova nuk kthehet në statusin e përpara 1999-s, Kosova nuk bashkohet me shtetet e tjera'. Gjithashtu, paketa e Ahtisarit dizajnonte një Kosovë demokratike dhe shumetnike, duke synuar mënjanimin e 'shtetit etnik tradicional'. Në tërësinë e vet Paketa e Ahtisarit, e shndërruar në Kushtetutë, arriti të krijonte Kosovën e sotme, me paqe të qëndrueshme të brendshme dhe me kontribut paqësor në Ballkan.

Paketa e Ahtisarit rezultoi kushtetutë e suksesshme. Nëse sot Kosova përballlet me sfida në marrëdhëniet me pakicat serbe, kryesisht në veri dhe me Serbinë në tërësi, këto sfida burojnë kryekëput nga Beogradi, nga doktrinën nacionaliste serbe, nga Kushtetuta e Serbisë si dhe nga politikat e sotme të saj. Sikundër burojnë edhe nga aleatët e mëdhenj të Serbisë, në mënyrë të veçantë Rusia. Kushdo që të jetë negociator i Kosovës dhe kushdo që ta përpilojë strategjinë negociuese të saj, lypset ta mbajë në themel Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Aty përcaktohen 'vijat e kuqe' përtej të cilave nuk mund të shkojë asnjë negociator dhe nuk mund të përpilohet asnjë strategji. Shkelja e kuadrin kushtetues në thelb sjell në mënyrë të pashmangshme dështimin e shtetit të Kosovës në tërësi. Kolonat kushtetuese janë akti publik i fuqisë, i qëndrueshmërisë, i funksionalitetit dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës.

Së dyti, do t'i sugjeroja Kosovës të veprojë në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm ndërinstitucional. Politikëbërja dhe vendimmarrja në politikën e jashtme të Kosovës janë kompetencë e një sërë institucioneve të parashikuara qartësisht në kushtetutën e saj. Sistemi politik i Kosovës dhe i Serbisë ka ndryshime të rëndësishme edhe në këtë aspekt. Edhe statuset kushtetuese të presidentëve të të dy vendeve ndryshojnë. Presidenti i Serbisë zgjedhet drejtpërdrejt nga populli. Si i tillë, ai është përfaqësues drejtpërdrejt i sovranit ashtu sikundër edhe Parlamenti i Serbisë. Presidenti i Kosovës, si përfaqësues i sovranit, ka tagër legjitim më të gjerë dhe të fuqishëm të përfaqësimit të Serbisë edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndonëse, si në çdo sistem politik të tillë, parimi 'check and balance' e detyron edhe presidentin e Serbisë të



gjejë bashkëvendimmarrje me Parlamentin e Serbisë, ku në fund të fundit, ratifikohen gjithë marrëveshjet ndërkombëtare të negociuara dhe të firmosura nga Presidenti i Serbisë.

Presidenti i Kosovës zgjidhet nga parlamenti, në opsionin ultimar, me shumicë të thjeshtë. Ky president nuk është përfaqësues drejtpërdrejt i sovranit. Sovraniteti në Kosovë bartet te Kuvendi i Kosovës. Kjo e bën Kosovën Republikë Parlamentare të qartë. Presidenti i Kosovës nuk ka tagër legjitimiteti të sovranit. Kompetencat e tij janë të dobëta dhe të limituara në përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës. Në dimensionin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në politikën e jashtme Kosova është ndërinstitucionale. Parlamenti dhe Komisioni i Politikës së Jashtme, Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme, Presidenti dhe Gjykata Kushtetuese janë në tërësinë e tyre institucionet që përfshihen në politikëbërjen dhe në vendimmarrjen e politikës së jashtme të Kosovës. Kushdo qoftë negociatori i Kosovës dhe kushdo që ta përpilojë strategjinë e negociimit të saj

Ballë sfidave të mëdha



lypsjet ta konsiderojë këtë tërësi institucionesh politikëbërëse dhe vendimmarrëse në politikën e jashtme. Shpërfillja ose anashkalimi i ndërinstucionalizmit prodhon politika jolegjitime, jo të qëndrueshme e jo të zbatueshme. Shpërfillja dhe anashkalimi ndërinstucional do ta fuste Kosovën në krizë të thellë politike që do të gjenronte pasojat edhe në marrëdhëniet me fqinjët dhe me mbarë Ballkanin.

Së treti do t'i sugjeroja Kosovës të veprojë në bashkëpunim me partnerët strategjikë politikë ndërkombëtarë. Projekti i shtetit të Kosovës qysh në fillimin e tij është produkt i partneritetit strategjik ndërkombëtar. Në këtë partneritet strategjik ndërkombëtar kanë spikatur veçanërisht Shtetet e Quintit, ShBA, Gjermania, Britania, Franca dhe Italia. Shqipëria është gjithashtu pjesë e këtij partneriteti politik strategjik për Kosovën, por me peshë të limituar ndërkombëtare. Këta partnerë strategjikë vulosën Republikën e Kosovës dhe njohjen ndërkombëtare të saj. Në këtë konstelacion partneriteti politik strategjik kohët e fundit po lakohet edhe Bashkimi

Evropian. Këtu ka një paqartësi. Bashkimi Evropian, bazuar në traktatin e tij, nuk ka një politikë të jashtme unike. Politika e jashtme e BE-së është kryesisht atribut i shteteve anëtare individuale të saj. Ka aspekte që BE-ja arrin konsensus në politikën e jashtme, sikundër ka edhe aspekte ku shtetet anëtare vendosin mbi bazën e interesave të tyre individuale. Në qëndrimin ndaj shtetit të Kosovës, Bashkimi Evropian nuk ka arritur konsensus. Ka shtete që e kanë njohur Kosovën, sikundër ka edhe shtete që nuk e kanë njohur atë. Pra, ka shtete pro Kosovës, sikundër edhe pro Serbisë. Ndaj Kosovës Bashkimi Evropian si nivel organizate është i dyzuar në mënyrë kontradiktore. Për këtë arsye Bashkimi Evropian ka përcaktuar pozicionin 'neutral' ndaj statusit politik të Kosovës. Bashkimi Evropian ndërmjetson negociatat teknike sepse kaq ka mandat. Bashkimi Evropian si organizatë nuk merret fare me statusin politik final të Kosovës. Por, normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi po bëhet kryekëput çështje politike. Në këtë aspekt Bashkimi Evropian si nivel organizate është i përçarë, i

dobët dhe për këtë arsye nuk është dhe nuk ka se si të jetë partner politik strategjik i Kosovës. Kjo nuk cenon aspak rëndësinë e Bashkimit Evropian për Kosovën në aspekte të tjera të bazuara në Traktatin e Lisbonës, siç janë fusha ekonomiko-tregtare, katër lëvizjet e lira, rendi dhe ligji, *acquis communaires*

dhe në bashkëpunimin ndërqeveritarë në fusha politike, sigurie dhe diplomatike ku BE-ja ka arritur konsensus.

Partnerët politikë strategjikë të Republikës së Kosovës kanë qenë dhe mbeten ShBA-ja, Gjermania, Britania, Franca, Italia dhe specifikisht Shqipëria. Natyrisht Kosova ka mbështetje shumë më të madhe përfshirë fqinjët, vendet e rajonit, anëtarët të BE-së, NATO-s dhe të OKB-së. Por, shtetet e Quintit, plus Shqipëria, kanë mbajtur një qëndrim unik dhe në kontinuitet për Kosovën. Prandaj konsultimi dhe bashkëpunimi me to është 'condicio sine qua non' për Kosovën në çdo fazë të saj për sot dhe për shumë kohë. Republika e Kosovës dhe partnerët politikë strategjikë të Quintit dhe Shqipëria kanë një agjendë të përbashkët. Kosova është sukses i kësaj agjende. Kosova nuk mund të jetë dështim pikërisht për shkak të kësaj agjende. Kushdo që të jetë negociatori për Kosovën dhe kushdo që ta përpiqet strategjinë e saj negociuese lypset të jetë në konsultim dhe bashkëpunim permanent me shtetet e Quintit dhe me Shqipërinë. Në këtë mënyrë Kosova siguron mbështetjen dhe garanton një marrëveshje të arsyeshme, të drejtë dhe të dobishme për vete dhe për mbarë rajonin dhe të mbështetur dhe të garantuar ndërkombëtarisht. Në nivel ndërkombëtar Quinti dhe në nivel rajonal edhe Shqipëria janë mbështetja dhe garancia më e madhe për Kosovën dhe për mbarë Ballkanin.

"Epoka e re": Së fundi është bërë më mbizotërues mendimi se veçanërisht BE-ja po tregohet e padrejtë me Shqipërinë së cilës nuk po ia hap negociatat për anëtarësim dhe me Kosovën së cilës nuk po ia heq regjimin e vizave. Sa i bazuar është një mendim i tillë?

Bashkurti: E kam parë dhe dëgjuar shpesh këtë kritikë ndaj BE-së. Thënë të drejtën, më thetin sytë dhe më dhëmbin veshët kur e dëgjoj. Në më të paktën kjo kritikë është një recidivë e të kaluarës së marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe fuqive tradicionale evropiane. Në më të shumtën kjo kritikë është pasojë e dështimeve serioze të brendshme e të dy shteteve tona, Shqipërisë dhe Kosovës, për t'i përmbushur në kohë dhe me rigorozitet standardet dhe kriteret e kërkuara nga BE-ja për të gjithë vendet që kërkojnë t'i bashkohen organizatës.

Bashkimi Evropian dhe fuqitë e sotme evropiane që arritën ta ndërtonin Evropën e Bashkuar kanë bërë një revolucion në filozofinë dhe sistemet e tyre politike. Bashkimi Evropian është projekt i paqes kundër luftës, është projekt i demokracisë kundër diktaturave, është projekt ekonomisë së tregut të lirë kundër centralizmit e planifikimit, është projekt i kontributit të organizatës në nivel global kundër rivaliteteve imperiale tradicionale. Suksesi i projektit të BE-së është i padiskutueshëm dhe i pakontestueshëm. E ardhmja e tij është e ndritur. Asnjë lloj nacionalizmi, euroskepticizmi, populizmi nga brenda dhe asnjë lloj ndërhyrje gjeopolitike nga jashtë nuk mund ta shkatërrojë projektin e BE-së. Vendet aspirante, si Shqipëria dhe Kosova, lypset të vijojnë pa hezitim, në mënyrë konsistente dhe dinamike, rrugën drejt BE-së. Të dy vendet e popujt tanë duhet të çlirohen nga paragjykimet e së kaluarës. Sikundër të dy vendet dhe popujt tanë nevojitet t'i përmbushin rigorozisht standardet dhe kriteret e BE-së në planin politik, juridik, ekonomik dhe administrativ. Kritikat duhet t'ia drejtojmë vetes sonë. Pra, të bëhemi vetëkritikë.

Shqipëria është në krizë politike, institucionale, ekonomike dhe sociale

"Epoka e re": Situata politike në Shqipëri ka marrë një kah tjetër e cila është tensionuar pas veprimeve të fundit të opozitës dhe mbajtjes së zgjedhjeve lokale nga ana e kryeministrit Edi Rama pa një konsensus të përgjithshëm. Kjo situatë ku do ta shpie Shqipërinë?

Bashkurti: Shqipëria është në krizë politike, institucionale, ekonomike dhe sociale. Krizat e bashkëshoqërojnë edhe demokracinë. Aftësia e sistemit demokratik është se i ka të gjithë mekanizmat për të parandaluar, për ta zgjidhur dhe për t'i menaxhuar krizat. Edhe

Shqipëria i ka këto mekanizma. Nëse kriza po zgjatet, kjo buron nga disa vështirësi që kanë rrjedhur nga qeverisja dhe papërgjegjshmëria e mazhorancës, nga ngadalësimi i disa reformave në vend, sidomos i asaj në drejtësi, nga aftësia dhe përgjegjshmëria e opozitës si dhe nga mungesa e respektimit të institucioneve kushtetuese në vend. Por, kriza ka edhe anën e mirë të saj. Ajo po e shkund Shqipërinë për të dalë nga tranzicioni. Por vë në lëvizje shoqërinë shqiptare për të qenë pjesëmarrëse më aktive në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Kriza po shtron nevojën për një reformim të thellë e të plotë të sistemit politik, institucional, ekonomik dhe social të vendit, për t'u përshtatur më mirë e më funksionalisht me sistemin e demokracive liberale perëndimore. Kriza do ta nxjerrë vendin nga status quoja aktuale. Natyrisht, pikënisja e kësaj kthese, për mendimin tim, nis me domosdoshmërinë e zgjedhjeve të lira e të ndershme, nga ku do të konstituohen organet legjitime, transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse të vendit, që do ta mundësojnë ecurinë e shpejtë drejt integritimit të tij në BE.

Hoxha: Zhgënjyese nëse ndërlihet liberalizimi me vazhdimin e dialogut

PRISHTINË, 17 KORRIK - Ministrija e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se ndërlihdja e mundshme e procesit të liberalizimit të

vizave për Kosovën me dialogun politik me Serbinë do të ishte zhgënjyese. Ajo në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se ka ten-

denca të tilla, përkundër faktit se duhet të pranojmë se ka pasur kërkesa, qoftë për suspendimin e taksës, qoftë për vazhdimin e dialogut. Po

ashtu, ministria Hoxha ka thënë se liberalizimi i vizave është në hapin e fundit për shqyrtimin e Këshillit të Ministrave.



Hoxhaj thotë se dialogut Kosovë - Serbi i duhet qartësi

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, gjatë takimit që ka pasur të mërkurën me delegacionin britanik ka theksuar se dialogut i duhet qartësi dhe një kornizë kohore për arritje të marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë



EPOKA E ENJTE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të mërkurën në takim shëfën e Departamentit për Ballkanin Perëndimor në Zyrën e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Andrew Page, si dhe Susan Laffey, zyrtare e lartë e Sektorit të Analizës në Zyrën për Punë të Jashtme.

Në këtë takim u diskutua rreth temave aktuale politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë, por theks i veçantë iu dha dialogut me Serbinë për arritjen e një marrëveshjeje finale me njohje reciproke.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka potencuar se dialogu me Serbinë është temë shumë e

rëndësishme për Qeverinë e Kosovës dhe se ka përkushtim që të arrihet marrëveshje finale me njohje reciproke dhe anëtarësim në OKB. Hoxhaj ka thënë se dialogut i duhet qartësi dhe një kornizë kohore për arritje të marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Hoxhaj dhe Page u pajtuan se mbështetja e aleatëve perëndimorë në dialog me Serbinë është tejet e rëndësishme për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Me delegacionin britanik të mërkurën është takuar edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Ndër çështjet që janë diskutuar në këtë takim kanë qenë edhe Procesi i Berlinit, të arriturat dhe fushat ku duhet fokusuar në të ardhmen, ku kryetari Kurti ka sugjeruar se Procesi i Berlinit

duhet të iniciojë një fond për zhvillim ekonomik të ngjashëm për Ballkanin siç ishte Plani i Marshallit për Evropën, me fokus të veçantë në qytetet e ndara. Sa i përket dialogut me Serbinë, Page ripërsëriti qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar e cila është kundër iniciativës për ndryshimin e kufijve.

Delegacioni i Britanisë së Madhe, i kryesuar nga shefi i Departamentit për Ballkanin Perëndimor, Andrew Page, si dhe zyrtarja e lartë e Sektorit të Analizës në Zyrën për Punë të

Jashtme, Susan Laffey, një ditë më parë është takuar në takime të ndara edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj.

Drejtuesit e institucioneve të Kosovës kanë kërkuar përkrahjen e Britanisë për procesin e dialogut me Serbinë. Po ashtu, zyrtarët kosovarë dhe ata britanikë kanë shprehur përkushtimin për ta thelluar bashkëpunimin bilateral ndërmjet dy vendeve. Fatmir Limaj ka vlerësuar se dialogu për nor-

malizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve është i paalternativë.

Ai ka thënë se palët duhet ta gjejnë formulën për ta arritur marrëveshjen përfundimtare e cila ka për qëllim njohjen reciproke. "Bashkërisht u pajtuam që dialogu mes dy vendeve është i paalternativë dhe se duhet gjetur rrugë deri tek arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes dy vendeve që për epilog do ta ketë njohjen reciproke", ka deklaruar zëvendëskryeministri Fatmir Limaj.

Gjykata Themelore e Gjilanit për gjashtë muaj ka zgjidhur 7 200 lëndë



GJILAN, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit, Ramiz Azizi, ka mbajtur të mërkurën një konferencë për media me gazetarë, duke shpalosur raportin gjashtëmuajor të Gjykatës. Ai ka thënë se kjo gjykatë i ka dhënë një prioritet zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit, ku gjatë këtyre gjashtë muajve është arritur të zgjidhen 14 lëndë të kësaj natyre, ndërsa kanë mbetur edhe 22 lëndë në punë. "Sanksionet penale për këto lëndë janë tri aktgjykime

dënim me burgim, një aktgjykim dënim me gjobë, dy aktgjykime dënim me kusht, pesë aktgjykime lirues dhe një aktgjykim refuzues", ka thënë Azizi. Për më tepër, ai ka shtuar se në këtë gjykatë nuk ka asnjë lëndë që është e shenjëstruar për liberalizim të vizave, pasi të gjitha janë gjykuar nga gjyqtarët.

Numri i lëndëve të pranuar në të gjitha departamentet gjatë kësaj periudhe kohore është 6 107 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të kryera është 7 209 lëndë, që do të

thotë 118 për qind është efikasiteti i kryerjes së lëndëve. Lëndë të mbetura në punë janë edhe 16 049 lëndë.

Gjyqtarët kanë nxjerrë 162 aktgjykime me burgim efektiv, 411 aktgjykime me gjobë, 321 aktgjykime me kusht, 35 aktgjykime lirues dhe 48 aktgjykime refuzues. Gjykata Themelore e Gjilanit çdo ditë e më shumë po punon për rritjen e transparencës me mediat dhe publikun, njëherësh po vazhdon publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme.

Arrestohet i dyshuari për vrasjen e 11-vjeçarit në Fushë-Kosovë

FUSHË-KOSOVË, 17 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës, pas ndërmarrjes së veprimeve të vazhdueshme hetimore dhe operacionale lidhur me rastin e raportuar para pak ditësh për vrasjen e një fëmije 11-vjeçar në Fushë-Kosovë, ka arrestuar një person të dyshuar. "Policia e Kosovës, pas ndër-

marrjes së veprimeve të vazhdueshme hetimore dhe operacionale lidhur me rastin e raportuar më datën 11. 07. 2019, e cilësuar në fillim si 'vdekje e dyshimtë', më datën 16. 07. 2019 rreth orës 19:55 nga njësitë policore të Stacionit Policor të Fushë-Kosovës është

arrestuar personi i dyshuar me inicialet S. O., ashkali, lindur në vitin 1999", është bërë me dije në njoftimin e policisë.

Rasti i raportuar më 11 korrik fillimisht është cilësuar si "vdekje e dyshimtë", ndërsa pas veprimeve hetimore dhe operacionale dhe me urdhër të

prokurorit të shtetit ky rast është rikualifikuar si vepër penale "vrasje e rëndë". "Personi i arrestuar, i dyshuar për veprën penale 'vrasje e rëndë', me urdhër të prokurorit kompetent është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës dhe pas intervistimit është



dërguar në mbajtje për procedura të mëtejme ligjore", është thënë në njoftimin e policisë.

Në Ministri të Mbrojtjes është mbajtur të mërkurën konferenca "Lansimi i planit të integritetit 2019-2022"

Ambasadori i Norvegjisë kërkon nga institucionet e Kosovës që ta luftojnë korrupsionin

Ambasadori i Norvegjisë në Republikën e Kosovës, Per Strand Sjaastad, ka thënë se Kosova në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha për ta luftuar korrupsionin, por ai ka sugjeruar që duhet organizuar plane strategjike më të shpeshta sikur kjo "Lansimi i planit të integritetit 2019-2022" për luftimin e korrupsionit. "Dihet edhe nga përvojat paraprake që luftimi i korrupsionit sjellë në vete edhe rreziqe, por kjo nuk do të thotë që duhet ndaluar së luftuari atë. Mbi këtë çështje, për luftimin e kësaj dukurie negative, duhet punuar fuqishëm dhe bashkërisht", ka thënë ambasadori Sjaastad

Mbrojtjes së Norvegjisë, atashë ushtarakë si dhe gjeneralë të FSK-së, oficerë dhe zyrtarë të NALT-it, përfaqësues të shoqërisë civile, oficerë të FSK-së dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në fjalën e hapjes së konferencës lansimi i planit të integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci, ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, duke folur për rëndësinë e këtij plani, ka thënë se një ndër mekanizmat e nevojshëm, krahas mekanizmave të tjerë për funksionim dhe kontroll të brendshëm, pa dyshim ka qenë themelimi i mekanizmit për avancim të integritetit në këtë ministri. Në konferencën e lansimit të planit të integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, duke folur në kontekst më të gjerë institucional dhe shtetëror, ministri Rustem Berisha ka thënë se ky plan është

derivat i politikave të Ministrisë së Mbrojtjes në funksion të fuqizimit dhe zhvillimit të mëturshëm të institucionit që drejton konform misionit të ri. Ai ka thënë se plani i integritetit zë vend të rëndësishëm në kuadër të dokumenteve strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe është në përputhje me Strategjinë Kundër Korrupsionit në nivel të shtetit. "Integriteti është një vlerë që duhet të mishërohet në punën tonë ditore. Integriteti ngërthen angazhimin individual dhe institucional në funksion të kryerjes së detyrave në përputhje me konceptin e sundimit të ligjit. Plani, si i tillë, parasheh masa konkrete në drejtim të përmirësimit dhe fuqizimit të segmenteve të rëndësishme në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes si dhe në nivel të Forcës. Është e rëndësishme që realizimi i këtyre masave ta avan-

cojë menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimit, financave, kontrollit të brendshëm dhe të aseteve", ka thënë ministri Berisha. Ndërsa ambasadori i Norvegjisë në Republikën e Kosovës, Per Strand Sjaastad, ka thënë se zbatimi i ligjit në rend të parë është detyrim. "Kosova në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha për luftimin e kësaj dukurie, por ju sugjeroj se duhet organizuar plane strategjike më të shpeshta sikur kjo për luftimin e korrupsionit. Dihet edhe nga përvojat paraprake që luftimi i korrupsionit sjellë në vete edhe rreziqe, por kjo nuk do të thotë që duhet ndaluar së luftuari atë. Mbi këtë çështje, për luftimin e kësaj dukurie negative, duhet punuar fuqishëm dhe bashkërisht", ka thënë ambasadori Per Strand Sjaastad.

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

zëvendësministri Burim Ramadani, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë Per Strand Sjaastad, Svein Eriksen, këshilltar i lartë i Qendrës së Integritetit në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) nga Ministria e

PRISHTINË, 17 KORRIK - Në Ministri të Mbrojtjes u mbajt konferenca "Lansimi i planit të integritetit 2019-2022", ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha,



Limaj përkujton bashkëluftëtarët: Sot po i nderojmë shenjat e lirisë dhe të lavdisë



RAHOVEC, 17 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë të mërkurën në shënimin e 21-vjetorit të Epopës së Rahovecit. Me këtë rast, Limaj ka thënë se sot si çdo vit tjetër nderojnë anekënd Kosovës shenjat e lirisë dhe të lavdisë, shenja këto që bënë të mundur që tash e 20 vjet ky shtet të jetojë i lirë. "Ne jemi këtu sot falë gjakut, sakrificës, përpjekjes që kanë bërë njerëzit e Kosovës. Jemi sot në Rahovecin e lirë falë sakrificës dhe përpjekjes të jashtëzakonshme të djemve dhe vajzave të Rahovecit dhe Anadrinisë", ka thënë Limaj. Më tutje, Limaj ka thënë se pas

rënies së komandantit legjendar Adem Jashari, Serbia po përpieq që ta izolonte Drenicën, por djemtë e Kosovës, sipas tij, nuk lejuan të përsëritet historia dhe të izolohet Drenica. Limaj që në luftë mbante nofkën Çeliku ka thënë se ky ishte një sinjal i qartë se lufta e UÇK-së do të shpërndahej anekënd Kosovës. Në Epopenë e Rahovecit kanë rënë edhe disa bashkëluftëtarë të Limajt për të cilët ai ka thënë se i nderojnë të gjithë dëshmorët duke iu shprehur mirënjohjen e përkuljen për sakrificën e tyre për lirinë e Kosovës. "Janë dhjetëra burra, shokë të cilët ranë për të mos vdekur kurrë. Le

të vazhdojmë t'i ruajmë kujtimet më të mira. Ju si familjarët për prindërit e juaj, vëllezërit, të afërmit dhe ne si bashkëluftëtarë që ndamë çastet më të mira dhe të vështira të jetës sonë. T'i ruajmë ato kujtime për ta kujtuar që atë që gëzojmë sot me të shtrenjtën, lirinë, askush nuk na ka falur", ka shtuar Limaj. Përveç akademisë përkujtimore, Limaj ka bërë homazhe edhe pranë lapidarit të dëshmorëve të kombit si: Sadik Shala, Agim Qelaj, Hamdi Berisha, Liman Gegaj, Bajram Veliu, Afrim Krasniqi, Faik Rama si dhe pranë monumentit të luftëtarëve të shquar Toni dhe Mici.

Mbi 16 000 çifte u kurorëzuan në vitin 2018

Në vitin 2018 në Kosovë janë kurorëzuar 16 871 çifte bashkëshortore. Nga gjinia femërore, me përkatësi etnike shqiptare janë 94.0 për qind, kurse 95.8 për qind janë meshkuj të përkatësisë etnike shqiptare. Kështu është bërë me dije nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në raportin e publikuar "Statistikat e kurorëzimeve në Kosovë 2018". Sipas këtij raporti, mosha mesatare e të martuarve ishte 30 vjeç



tare e të martuarve ishte 30 vjeç. Prej tyre moshë mesatare e meshkujve ishte 31 vjeç, kurse moshë mesatare e femrave ishte 28 vjeç. "Në kurorëzimet sipas grupmoshave dominojnë femrat e moshës 20-24 vjeçare me 5 398, ose 32.0 për qind, ndërsa të meshkujt dominon moshë 25-29 vjeçare me 5 341, ose 31.7 për qind. Më së shumti kurorëzime ishin në Komunën e Prizrenit, 1 589 raste, ose 8.7 për qind, pastaj vjen Prishtina me 1 285 kurorëzime, ose 7.0 për qind, ndërsa në Ferizaj ishin 1 067 kurorëzime, ose 5.8 për qind etj", është theksuar në raportin e ASK-së, duke u shtuar se sipas përgatitjes shkollore, dominojnë femrat dhe meshkujt me shkollë të mesme. Numri i femrave të kësaj kategorie ishte 10 602, ose 62.8 për qind, kurse e meshkujve ishte 11 701, ose 69.4 për qind.

EPOKA E ENJTE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e kurorëzimeve në Kosovë 2018". Të dhënat në këtë publikim si bazë kanë të dhënat administrative të marra nga zyrat e gjendjes civile në Kosovë. Sipas ASK-së, në vitin 2018 janë grumbulluar gjithsej 18 332 fleta statistikore

për kurorëzime DEM-3. "Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë në vitin 2018 janë kurorëzuar 16 871 çifte bashkëshortore. Nga gjinia femërore, me përkatësi etnike shqiptare janë 94 përqindësh, kurse 95.8 për qind janë meshkuj të përkatësisë etnike shqiptare. Femra me përkatësi etnike serbe janë 1.1 për qind dhe meshkuj 1.1 për qind; femra të përkatësisë etnike turke janë 0.4 për qind,

kurse meshkuj janë 0.5 për qind; femra me përkatësi etnike boshnjake janë 1.1 për qind, kurse meshkuj janë 1 për qind; femra me përkatësi etnike rome, ashkali dhe egjiptiane janë 1.2

për qind, kurse meshkuj janë 1.3 për qind; femra me përkatësi tjetër etnike janë 2.3 për qind, kurse meshkuj 0.4 për qind", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, moshë mesa-

Policia arreston personin që vodhi mbrojtëset anësore në autostradë

SKENDERAJ, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka vazhduar praktikën e nisur në qeverisjen e tij, atë të publikimit të kontratave publike me operatorë ekonomikë, për projektet kapitale, furnizime dhe shërbime të tjera. "Kjo është faza e tretë e publikimit që prej së kryetari Jashari mori detyrën në dhjetor të vitit 2017. Është zotuar se do të jetë e hapur dhe publike çdo kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit të komunës dhe operatorëve ekonomikë për t'u bërë transparent gjithashtu dhe



çdo shpenzim i parasë publike, në përputhshmëri të plotë me vizionin e qeverisjes së tij, obligimin kushtetues dhe moral", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Skenderajt. Në njoftimin e komunës theksohet se "veprimet e kryetarit Jashari janë vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare, USAID-i dhe organizatat joqeveritare të vendit dhe të huaja, që monitorojnë punën e organeve komunale, janë model i vendosjes së standardeve demokratike të transparencës ndaj publikut".



Kryetari i Skenderajt vazhdon publikimin e kontratave publike

SKENDERAJ, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka vazhduar praktikën e nisur në qeverisjen e tij, atë të publikimit të kontratave publike me operatorë ekonomikë, për projektet kapitale, furnizime dhe shërbime të tjera. "Kjo është faza e tretë e publikimit që prej së kryetari Jashari mori detyrën në dhjetor të vitit 2017. Është zotuar se do të jetë e hapur dhe publike çdo kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit të komunës dhe operatorëve ekonomikë për t'u bërë transparent gjithashtu dhe

çdo shpenzim i parasë publike, në përputhshmëri të plotë me vizionin e qeverisjes së tij, obligimin kushtetues dhe moral", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Skenderajt. Në njoftimin e komunës theksohet se "veprimet e kryetarit Jashari janë vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare, USAID-i dhe organizatat joqeveritare të vendit dhe të huaja, që monitorojnë punën e organeve komunale, janë model i vendosjes së standardeve demokratike të transparencës ndaj publikut".

QMF-ja në Kijevë do të jetë e mbyllur nga data 23 korrik për shkak të punimeve

MALISHEVË, 17 KORRIK (ER) - Qendra e Mjekësisë Familjare në Kijevë (QMF) do të jetë e mbyllur nga data 23 korrik, për 45 ditë pune, për shkak të punimeve që do të kryhen për meremetimin e objektit. Lajmin e ka bërë me dije drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, sipas të cilit, në objektin e QMF-së do të investohen 22 800 euro nga organizata zvicerane AQH, e cila në vazhdimësi ndihmon shëndetësinë në Malishevë. Qendra e Mjekësisë Familjare me gjithë stafin do të barten në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Llazicë deri në përfundimin e punimeve.



Muzafer Shala emërohet ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar të mërkurën Muzafer Shalën

ministër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. "Kam emëruar sot ministër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer

Shalën. Pasi i dëshirova punë të mbarë në detyrë, me ministrin e ri biseduam për vazhdimësinë e projekteve në

këtë dikaster", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Mbi 10 mijë nënshkrime për heqjen e homologimit, peticioni dorëzohet në Kuvend

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 KORRIK - Më shumë se 10 mijë qytetarë kanë nënshkruar peticionin për heqjen e homologimit. Ky peticion është dorëzuar të mërkurën në Kuvendin e Kosovës. Nënshkruesit e këtij peticioni kërkojnë nga Kuvendi që Ligji për Automjete të ndryshohet dhe obligimi për homologim të hiqet në tërësi.

Peticioni është iniciuar nga ekonomisti Hekuran Murati pas debatit që është zhvilluar në Kuvendin e Kosovës për homologimin e automjeteve. Në këtë peticion thuhet: "Prishja e monopolit nuk mjafton, por është duke u kërkuar që Kuvendi ta ndryshojë Ligjin për Automjete dhe se nuk ka nevojë që 99 për qind e qytetarëve të paguajnë kot për shkak se një për qind tjetër importon vetura të pastandard-izuara".

Aktualisht në Kosovë ky shërbim kryhet vetëm nga kompania "EuroLab".

Lidhur me këtë peticion ka folur iniciuesi Hekuran Murati, i cili ka thënë se detyrimi për

homologim është plaçkë që po u bëhet qytetarëve të Kosovës, duke i detyruar të paguajnë shumën prej 100 eurosh që, sipas tij, verifikimin në mes të konditave të makinës dhe librezës poseduese do të mund ta bënte edhe Dogana e Kosovës. Ai ka thënë se organizatorë të këtij peticioni janë 10 mijë qytetarë të Kosovës. "Kërkesa jonë është që obligimi për homologim të hiqet në tërësi për shkak se është vetëm një plaçkë për qytetarët. Aty nuk bëhet kurrfarë homologimi, pasi qytetarët mashtrohen. Në atë kompani krejt çka bëhet është verifikimi i të dhënave të veturës me librezën që posedon ajo veturë dhe për këtë plaçkë qytetarëve u merren nga 100 euro", ka thënë Murati, duke shtuar se kompania "EuroLab" nuk bën asgjë më tepër pos atë çfarë mund ta kishte bërë edhe Dogana e Kosovës.

Ai ka apeluar te ligjvënësit që ky peticion të shqyrtohet me seriozitet dhe të hiqet në tërësi homologimi i makinave. "Qytetarët e Kosovës paguajnë më së shtrëngti për importim të veturave, prandaj shpresoj se deputetët e Kuvendit do ta mar-



rin parasysh këtë kërkesë dhe këtë vullnet të qytetarëve. Duhet të bëhen së paku gjashtë deputetë apo do të thosha gjashtë heronj që ta çojnë përpara këtë ndryshim të nevojshëm të ligjit për automjete. Besoj se nuk do të jetë vështirë për t'i gjetur gjashtë deputetë për këtë nismë", u shpreh ai.

Murati ka theksuar se shumica e veturave që importohen vijnë tani në sezonin veror. Ai ka thënë se sipas pasqyrave financiare të "EuroLab"-it, janë 40 milionë euro në vit prej këtij homologimi, apo 15 mijë euro

në ditë mesatarja.

Për çështjen e monopolit të tregut të veturave kanë reaguar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Philip Kosnett, dhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Ata i kanë bërë thirrje qeverisë të veprojë shpejt për zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Kosovës për eliminimin e rasteve të monopolit në treg, siç është rasti me homologimin e veturave.

Në vitin 2017 edhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kishte konstatuar shkelje ligjore në

fushën e homologimit, duke i rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës që të rishikojë dhe të bëjë ndryshime në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Në vitin 2008 atëkohë Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit kishte nënshkruar kontratë me kompaninë "EuroLab" për homologimin e automjeteve që regjistroheshin për herë të parë në Kosovë, duke e autorizuar kompaninë në fjalë si të vetmen për këtë veprimtari për periudhën 2009-2019.



'10 rregullat e arta të sigurisë rrugore' drejt një komunikacioni më të sigurt

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit të mërkurën ka bërë lansimin e fushatës "10 rregullat e arta të sigurisë rrugore", vazhdimësi e aktiviteteve të kësaj ministrie drejt sensibilizimit të pjesëmarrësve në komunikacion për qarkullim të sigurt.

Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Idriz Selimaj, i cili ka bërë edhe hapjen e kësaj fushate në pikën kufitare në Merdare, ka theksuar se MIT-ja me anë të kësaj

fushate ka për synim uljen e numrit të aksidenteve, veçanërisht gjatë sezonës së verës, ku edhe rritet numri i përgjithshëm i mjeteve qarkulluese.

Broshura që rikujton disa nga shkeljet që rrezikojnë jetën e pjesëmarrësve në trafik është shpërndarë te vozitësit që kanë qarkulluar përmes pikës kufitare Kosovë - Serbi, ndërsa do të vazhdojë të shpërndahet edhe në pikat kufitare të tjera. Iniciativa e sotme është bashkëpunim i MIT-së dhe Policisë së Kosovës.

AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 48

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 48 përmes metodës së likuidimit ka shpallur të mërkurën çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje.

Për 116 asetet sa ishin në shitje vlera e tërësishme e ofertave më

të larta ishte 970 382 euro. Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm.


Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar

nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (3)

Pesë argumentet



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Argument 1

Këtë teori që po e jap personalisht unë, e forcon edhe më shumë argumenti se deri më sot asnjëherë nuk ka ndodhur që të shpërthejë ndonjë vullkan i cili nga brendësia e tokës do të nxirrte hekur të pastër që rrjedh si uji, sepse kjo masë likide e hekurit (Fe) nuk ekziston në anët anësore të diopolit magnetik, por ekziston vetëm mbi polet magnetike të tokës. Pasi polet magnetike e tërheqin këtë masë dhe nuk lejojnë të ndahet dhe të dalë mbi sipërfaqen e tokës, për aq kohë sa të jetë aktive fusha magnetike e tokës. Prandaj përfundimisht brenda strukturës së brendshme të tokës, rreth dipolit magnetik mund të ketë çfarëdo lloji elementi në gjendje likide, por në asnjë mënyrë nuk ka hekur të pastër likid.

Argument 2

Po të marrim një enë dhe të vendosim në të një përzjerje hekuri dhe nikeli, pastaj e vendosim mbi një makinë që e rrotullon enën me shpejtësi të lartë këndore konstante, do të vërtetojmë se pas një kohe kjo përzjerje do të rrotullohet me të njëjtën shpejtësi këndore sikur ena, nga fakti se ekziston një kontakt në mes enës dhe përzjerjes e kjo bartet nga sipërfaqja deri në qendër. E njëjta ndodhë edhe me tokën, sepse shtresa e jashtme e tokës është e ngurtë. Po të kishte likid të përzjerjes së hekurit (Fe) e nikelit brenda tokës, do të rrotullohej në të njëjtën kohë dhe me shpejtësi këndore të njëjtë me tokën. Prandaj në asnjë rrethanë nuk do të ketë një përzjerje të hekurit (Fe) dhe nikelit prej nga do të krijohet ndonjë fushë magnetike.

Argument 3

Pjesa më e madhe e shkencëtarëve e marrin se rryma elektrike dhe fusha magnetike formohen për shkak të temperaturave të larta gjatë përzjerjes së hekurit (Fe) dhe nikelit. Po të ishte kështu nëpër shkrirore ku futen qindra tonelata elemente të ndryshme për t'u shkriur, ku më së shumti ka hekur dhe një pjesë të nikelit, do të formohej ndonjë rrymë elektrike nga e cila do të formo-

hej ndonjë fushë magnetike, kjo nuk ka ndodhë, e as që do të ndodhë ndonjëherë.

Prandaj kjo teori e formimit të fushës elektrike dhe magnetike nga përzjerja e metaleve brenda tokës ashtu siç mendohet tani bie poshtë.

Argument 4

Argument tjetër që e vërteton se nuk ka sferë ferromagnetike brenda tokës, është se nëse të njëjtin magnet cilindrik e vëmë në një brendësi të një cilindri nga materiali i hekurit (Fe), do të shohim se intensiteti i fushës magnetike BA jashtë cilindrit të hekurit (Fe), afër sipërfaqes anësore zbrit në vlerën afërsisht (shih figurën 14).

Nga ky eksperiment shohim se sikur të ketë një diopol magnetik brenda mbështjellësit ferromagnetik të tokës, ashtu siç mendohej se mbështjellësi ferromagnetik përbëhet nga materialet ferromagnetik, fushë magnetike nuk do të kishte mbi planetin tonë.

Argument 5

Po të shikohet harta e fushës magnetike të sfera, apo të ndonjë magnet cilindrik, afërsisht intensiteti i fushës magnetike ka vlerën e njëjtë në polet magnetike, dhe vlerën e njëjtë në sipërfaqet anësore qoftë të sferës apo të cilindrit ashtu siç shihet në figurën e mëposhtme 15.

Kurse intensiteti i fushës magnetike në planetin e tokës nuk është i rregullt, sepse vlera maksimale e fushës magnetike në veri, në Rusi dhe Kanadë arrin në vlerën e 60 mT, por jo në polin magnetik të veriut aty ku buron fusha magnetike. Kjo vërtetohet edhe eksperimentalisht, nëse mbi polin magnetik të një cilindri vendosim pllakë të hekurit (Fe), intensiteti i fushës magnetike mbi polin magnetik në pikën (A) që ka vlerën në 8 mT, por që është më i ulët sesa në skajet e pllakës së hekurit (Fe) në pikat (B) dhe (C) ku arrin në 14 mT (shih figurën 16).

Lëvizja e polit magnetik të veriut

Kjo na jep të kuptojmë, se fusha magnetike e ka formën e një cilindri të lakuar, ashtu sikur shpeshherë në sipërfaqen e tokës paraqiten tornado me forma të ndryshme (shih figurën 17).

Argument tjetër që tornadoja elektromagnetike e formon dipolin magnetik të tokës është se poli magnetik i veriut bënë lëvizje më të madhe sesa poli magnetik i jugut, kjo ndodhë





Fig 15




Fig 16



Fig 17

Position des pôles magnétiques

| | | | | |
|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| Pôle Nord magnétique ¹⁴ | (2001) ♀ 81° 18' N, 110° 48' O | (2004) ♀ 82° 18' N, 113° 24' O | (2005) ♀ 82° 42' N, 114° 24' O | (2010) ♀ 85° 00' N, 132° 36' O |
| Pôle Sud magnétique ¹⁵ | (1998) ♀ 64° 00' S, 138° 30' E | (2004) ♀ 63° 30' S, 138° 00' E | (2005) ♀ 63° 06' S, 137° 30' E | (2010) ♀ 64° 24' S, 137° 18' E |




Fig 18

mën e cilindrit të drejtë apo të lakuar, dhe në një mënyrë qoftë përmes përzjerjes cilindrike apo fërkimeve të ndryshme e shkakton rrymën elektrike dhe fushën magnetike.

Jetëgjatësia e cikloneve dhe tornadove brenda trupave qiellorë

Jetëgjatësia e këtyre fenomeneve varet nga bërthama e atomeve të elementeve nga i cili reaksion janë krijuar tornadot elektromagnetike dhe ciklonet. Meqenëse në krijimin e Universit këto katër elemente ishin në masë të madhe, janë krijuar edhe bërthama jashtëzakonisht të mëdha qoftë të cikloneve apo tornadove, dhe zgjasin me mijëra e miliardë vite.

Por, gjithashtu edhe këto fenomene zgjasin varësisht nga prezenca e atomeve të elementeve (a?) në të cilën mund të haset gjatë rrugës në të cilën kalojnë këto fenomene natyrore.

Atomt e Elementeve (a?) është mjaft vështirë të depërtojnë në qendra të trupave qiellorë, dhe kjo ndihmon në jetëgjatësinë e tyre.

Çka janë elementet (aX) (aY) (aZ) dhe (a?)

Janë elemente që janë prezentë në gjithë Universin duke përfshirë edhe sipërfaqen dhe mbi sipërfaqen e tokës. Nuk njihen, nuk mund t'i shohim, është shumë vështirë t'i izolojmë, por shumë e rrezikshme t'i prodhojmë përmes laboratorëve

shkencore.

Nëse në laboratore tentohen të gjenden dhe të prodhohen këto atome, duhet kuptuar se një reaksion në mes atomeve (aX) (aY) dhe (aX) (aZ) është i pandalshëm, dhe nuk mund të izolohet në laborator, në këtë mënyrë një reaksion i tillë mund ta kalojë pa problem çdo lloj pengese dhe të dalin jashtë laboratorëve duke mos u vërejtur fare, dhe pasi të dalin në hapësirë bëjnë lëvizje të pakontrolluara. Kurse gjatë lëvizjeve mund të hasin rrugës në atome të tjera të cilat gjenden në hapësirë (aX) (aY) (aZ) duke formuar bërthama të cikloneve dhe tornadove, por edhe rrymime të ajrit në hapësirat ku kalojnë aeroplanët, këto fenomene mund të zgjasin me minuta, orë, javë dhe me vite dhe gjithë njerëzimin do ta zhdukim mbi sipërfaqen e tokës.

I vetmi element që mund t'i ndalë këto reaksione është elementi (a?) por nuk ka informata si duket dhe ku gjendet.

Fusha magnetike e trupave qiellorë të sistemit tonë diellor

Eksperiment 2

Ngjashëm sikur është formuar fusha magnetike e tokës, përmes bashkimit të bërthamave të ciklonit dhe tornados, në të njëjtën kohë apo në kohëra të ndryshme janë formuar të gjithë trupat në mbarë Universin. Por, ne do të ndalemi vetëm te trupat qiellorë të sistemit tonë diellor. Duke u bazuar në argumentin se përpos Tokës që posedon fushë magnetike janë edhe Dielli, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni që posedojnë të njëjtën fushë.


Kurse trupat e tjerë qiellorë Merkuri, Venera, Marsi dhe të gjithë satelitët natyrorë të planeteve që kanë një formë të rregullt gjeografike, përkatësisht sferike, janë krijuar nga bërthama e cikloneve (aX) dhe (aY).

Për të pasur më shumë informacione se si janë formuar trupat qiellorë, e marrim një disk (D) në të cilin e hapim një vrimë në mes për të kryer eksperimente. Përreth vrimës eksperimentale vendosim magnetet permanente në formë të cilindrave, të cilat përfaqësojnë dipolet magnetike të trupave qiellorë.

Në këtë vrimë eksperimentale hyjnë dhe dalin të gjitha fushat magnetike të të gjithë cilindrave magnetikë që ndodhen rreth vrimës eksperimentale (shih figurën 18). **Vijon.**

SHKRIMTARI PËRBALLË DIKTATURËS (2)

Përsiatje rreth librit të shkrimtarit Ismail Kadare,
"Kur sunduesit grinden"



Bedri ISLAMI

Ismail Kadare nuk e ka përcaktuar librin "Kur sunduesit grinden", as si roman, as si provë eseistike, as meditim. Thjesht ka shkruar, "Rreth misterit të telefonimit Stalin - Pasternak", por mund të përcaktohet si roman, me 13 kapituj e tij, që përbëjnë 13 variantet e mundshme të misterit; mund të jetë një tragjedi në 13 akte, shumë nga të cilët sillen nga personazhet femra, ashtu si mund të jetë një përsitje eseiste e klasit të parë mbi raportet mes diktaturës dhe artit, mes sunduesit të përgjakshëm dhe sundimtarit të shpirtit, ndërlihdja kohore, por edhe e tashme, në këtë binom të çuditshëm dhe që për shumë kohë nuk i është ndarë botës; enigmës së krijimit në diktaturë dhe mundësisë e gjetjes së rrugës së daljes prej zezimit; ankthit të përgjimit dhe çastit të krijimit, kaosit të krijuar në mendimin e poetit dhe dëshirës për të qenë i vetvetishëm; në fund të fundit një përballje ku kalërojnë pranë njëra tjetrës të dy mundësitë: vdekja dhe përsosja, nga që arti nuk do të kishte kurrë rrugë tjetër dhe ndjellësi i tij, poeti, nuk do të mund të kishte asnjë mundësi veçse të paguante një haraç kalimtar për të zhbërë rrëimin e më të rëndësishmes, kumtin e lirisë.

Cili është thelbi i bisedës tre minutash të bërë mes Stalinit dhe Pasternakut në të njëzetetretën ditë të qershorit të vitit 1934? Ismail Kadare na sjell të gjithë variantet e mundshme, mjedisin, personazhet, të njohur që futen në dramën e tyre duke qenë të dylloshëm, pjesë të jetës ose kureshtarë, miq apo lakmitarë, të tronditur apo duarferkues nga gëzimi, admirues të regjimit dhe të diktatorit apo kundërshtarë të heshtur të tij, njerëz të shënuar si të kryqëzueshëm apo të tjerë që do të shpërbleheshin bujarisht, përgjues dhe rebelë.

Vendi i dyanshëm, po ashtu. Në njërin skaj zyra e Stalinit në Kremlin. Kremlin do të thotë forcë, pushtet, eliminim, vrasje, kurrë paqe. Në skajin tjetër, apartamenti komunal i Pasternakut, rruga Volkhonka, në Moskë, me kuzhinë dhe banjo të përbashkët. Koridore të zgjatur dhe dyer që përplasen. Poskrebishevi telefonon.

Pasternaku nuk e ka dëgjuar kurrë zërin e tij. Diçka ndryshe nga zërat njerëzorë. Ftohtësisht i thotë, "Me ju do të flasë tani shoku Stalin". Për poetin gjithçka është e pabesueshme, por edhe e frikshme. Kërkon të shtyjë çastin e bisedës me mosbesimin e tij, por zëri i panjohur ngulmon. "Flisni shokut Stalin".

Në anën tjetër të telefonit është tashmë zëri i njohur me theksin e veçantë gjeorgjian. Hutimi i parë nuk është asgjë. E turbullt është ajo çka do të vijë më pas. Turbullimi i arrestimit të mundshëm, si shemrit, dytëzimit të tij, mundet që është i afërt. Një bisedë e bërë në rrugë, jo shumë kohë më parë, dhe leximi i poezisë turbulluese mund të jetë i njohur. Nuk ka kohë t'i mendojë të gjitha.

"Pak kohë më parë është arrestuar poeti Mandelshtam. Çfarë mund të thoni për të, shoku Pasternak?" Në një të dhjetën e sekondës mbi poetin shembet gjithçka. Çfarë është kjo: fillim i hetimit, hyrja në një ditë arresti, përmbyse e fatit, linçim i ardhshëm?

Përgjigjet në atë ftohtësinë e tij, që në këtë çast bëhet e akullt.

"Ne jemi të ndryshëm shoku Stalin. Unë pak e njoh atë"

"Kurse unë mund të ju them se ju jeni një shok shumë i keq, shoku Pasternak. Ne, bolshevikët e vjetër nuk i kemi braktisur kurrë shokët tanë kur binin në fatkeqësi".

Telefoni mbyllet.

Çasti i kthjellimit të Pasternakut vjen. Por, është vonë. Stalinit i është dashur vetëm për kaq. Jo për më tej. Për të, Stalinit, nuk janë të nevojshme bisedat filozofike për jetën a vdekjen, për poezinë apo dobësinë e Leninit ndaj Gorkit. Kaq ka qenë e menduar, e planifikuar dhe e duhur.

Pikë.

Në pak çaste, e gjithë Moska mëson se Pasternaku tradhton shokun e tij dhe pikërisht atëherë, kur Stalini donte ta mbronte.

Ndërsa heshtësi, Pasternaku, është i shpifuri, frikacak, tradhtonjësi, në të kundërtën, Stalini, është mëshirmadhi, i buti, njerëzori, njeriu që nuk i braktisë kurrë shokët e tij.

Në çastin e parë të zemërimit, mbamendjes, heshtjes, fjalëve pa fund, askush nuk pyet: nga kush duhej ta mbronte mikun e tij Mandelshtam? Nga vetja apo nga njeriu që kishte telefonuar?

Kush e kishte arrestuar atë dhe kush do e dërgonte drejt vdekjes? Ndarja e fajit nuk ishte bërë si ishte dashur: vdekja ishte llogaritur të rëndonte mbi poetin, duke çliruar tiranin.

Të trembëdhjetë versionet të duket si të trembëdhjetë kundër Pasternakut, që, edhe ai, ka ngritur

Tebën e tij. Nga e cila nuk ikën dot. Kur poeti kishte dashur të bënte dëshminë e tij, në skajin tjetër të telefonit nuk do të bëhej i gjallë askush. Ai numër ishte krijuar veç për një bisedë të vetme, atë që porsa kishte ndodhur dhe që mëtohej të ishte alibia e krimin.

Poeti, për një çast, ishte mposhtur. Mposhtja duhej shpallur, duhej bërë e njohur. Hapësira e lirisë ishte zënë. Në fronin e saj ishte ulur diktatori. Njëjtë si kishte ndodhur me poetin romak, Ovidi, dy mijë e ca vite më parë; njëjtë si me poetin filozof Seneka, njëjtë si me dëbimin e Dantes, përsëritje e pafund e kësaj ndeshje të pafund. Dhe ky është thelbi i "Kur sunduesit grinden", një temë e gjithëkohëshme, në të cilën gjenden, edhe një herë, përballë njëri tjetrit, diktatori, sunduesi i jetës, ai që mban në duar skeptrin e jetës dhe të vdekjes, dhe në anën tjetër, magjia e fjalës, e cila krijon ndjeshmërinë, endjen dhe dhëmbshurinë, idenë dhe vizionin, besimin e poetit.

Secili poet, artist, shkrimtar, pra, krijues, përcaktohet përgjithnjë në një çast të caktuar të jetës së tij dhe ky është çasti kur ai gjendet përballë vetvetes.

Kadare është gjendur në një çast të tillë. Në fakt, ai e ka ndjell një çast të tillë. Është ndodhur shpesh herë mes tmerrit dhe, po të mos kishte ndodhur kjo, ky libër do të ishte i pajetë, i panjohur dhe i pandodhur.

Ai është i vetëdijshëm për çfarë ka ndodhur dhe, nëse në librin e tij sjell trembëdhjetë versionet e një misterit, asnjëherë për të rënduar poetin, por të dëshmuar për gjendjen e pazakontë, kur ndjenja e së paditurës krijon atë moment që fare lehtë mund të quhej "të të lidhet goja".

Të trembëdhjetë aktet e tragjedisë së këtij libri janë si një proces hetimor, i qëmtuar ndër vite, pasi autori i është kthyer shpesh herë këtij gjurmimi, si një pjesë të vetvetes, kërkesë e vazhdueshme për të njohur të ndaluarën dhe të pamundurën.

Megjithatë një pyetje nuk është shtruar ende: Çfarë do të kishte ndodhur, nëse, në të kundërtën e asaj që dihet, pra të përgjigjes së vaktë, deri diku mohuese të Pasternakut, të kishte ngjarë krejt e kundërta:

Nëse, për një çast, në shpirtin e tij të ishte zgjuar rebeli i fjetur, të kishte ardhur çasti i guximit dhe i forcës, dhe, përkundër çdo pasojë që mund të kishte pasur, të kishte dëshmuar se Mandelshtami është një poet i madh, i matshëm me poetin e parë të Rusisë, se ai,

Mandelshtami kishte qenë dikur bir e ndjekës i revolucionit, pasi dy herë rradhasi mund të ishte pushkatuar nga Të Bardhët dhe, se në fund të fundit, poezia ndjekëse nuk ishte asgjë tjetër, veçse një çast i turbullt, i parëndësishëm. Nëse do i kishte thënë se mbajtja në burg e një poeti të tillë, mik i atij vetë, nuk i bënte nder askujt, as vetë Rusisë së Madhe, e cila nuk mund të kishte drojë nga vargjet e një poeti të mrekullueshëm.

Çfarë do të kishte ndodhur? Do të kishte poeti i burgosur një fat tjetër, krejt ndryshe, do të ishte i lirë pas kësaj bisede dhe do të kishte rendur drejt shtëpisë në ekstazën e lirisë?

I duhej vërtet Stalinit një dëshmi e poetit të parë të Rusisë për të lënë të lirë një sivëlla të tij?

Vërtet Stalini kishte nevojë për ndërhyrjen e Pasternakut për zbutjen e dënimit të Mandelshtamit?

A mund ta kishte shpëtuar ai mikun e tij nga tragjedia? A do të kishte mundur që përmes fjalës së tij të shpëtonte jetën e një poeti?

Hutimi i çastit ishte smirë e heshtur, drojë nga njeriu këmbëshkurtër, "maloku i Kremlinit", apo keqkuptim?

A mund të përsëritej çasti ose, më saktë, pengu i mosfoljes?

Megjithëse të gjitha mund të duken si enigmë e pazgjidhur, një gjë është e qartë:

Asgjë ndryshe nuk do të kishte ndodhur. Pasternaku ishte përllogaritur qetësisht për rolin e tij dhe, pas mpirjes, perdja kishte rënë.

Një vit pas misterit telefonik, ai do të ndërhynte te Stalini për shpëtimin e burrit të dytë të poetes rebele, Anna Ahmatova dhe djalit të saj, Lev Gumilovit.

Stalini, si për të dashur të risillte albinë e rastit Mandelshtam, ia merr parasysht ndërhyrjen dhe, Punini bashkëshort dhe Levi, biri i Ahmatovës, një javë pas letrës, lirohen nga burgu.

Si për të dashur të risillte gjithçka që kishte ndodhur, njëri nga "magjistrictët", i njëjti, sekretari fuqiplotë i shefit, Poskrebishevi, telefon në shtëpinë e re të Pasternakut për t'i dhënë lajmin e mirë.

Mos u zbut tirani nga fjala e poetit? Do të kishte ndodhur kështu edhe në rastin Mandelshtam?

Punini, bashkëshorti i dytë i Ahmatovës do të arrestohet tri herë dhe do të vdesë në një kamp internimi. I biri, Lev Gumilov, qendroi dhjetë vjet në burgje e kampe internimi. Ahmatova, poetja rebele, që nuk kishte pranuar të emigronte, pasi e quante tradhti ndaj gjuhës dhe kulturës së vet, të gjithë dhimbjen e saj të pashoqe

do e shprehte në Requim.

Diktatura, pikërisht në çastin që shkrimtari mendon se mund të jetë zbutur, atëherë jep edhe goditjen e rradhës.

Viti 1972 në Shqipëri do e përjetonte këtë dhe do të risillte gjëmën e radhës, por edhe më goditëse se ato që kishin shkruar, duke përjashtuar vitin 1945. Pas asaj zbutje të përkohshme të pushtetit, që dukej si një filluese e lirisë, fjalimit në një rrethinë kryeqytetase, në Mat, ku "prijësi" kishte shkruar deri në atë që mund të quhej absurde deri para asaj dite, pra, në këshillën e dhënë shkrimtarëve në reagimin e tyre ndaj redaktorëve, të cilëve, kur mos u pëlqenin librat e dërguar për botim, autorët t'i thonin, "merre, bëje vetë", kishte ardhur ngrica e marsit, përmes një plenumi të Komitetit Qendror, që shumë shpejt do të sillte akullimin e gjithçkaje. Një pyetje, në dukje e zakonshme, "kush është më i rrezikshëm, liberalizmi apo konservatorizmi", do të kishte një përgjigje makthi; artistë të arrestuar, drejtues të burgosur, valë largimesh dhe përjashtimesh, konservatorët janë në delir dhe njëri prej tyre, RB, do të deklarojë, duke pasur parasysht Ismail Kadarenë: "Gabim që i çmojnë veprat tona në Francë, ata duhen çmuar nga jehona në vatrën revolucionare të botës. Kot i bien në qafë konservatorizmit. Asnjë vepër konservatore nuk është ndaluar, si ato, modernistet". Nga Tirana largohen me ngut, më saktë, i largojnë ngultasi, disa nga poetët më të talentuar të një brezi të ri, të cilët synojnë poezinë moderne, janë shkëndijimet e fuqishme të një arti krejt ndryshe, e mes tyre, edhe dy nga më të shquarit e letrave shqipe, Mokom Zeqo dhe Xhevahir Spahiu, pa të cilët nuk mund të kuptohet letërsia e sotme shqipe.

Raporti mes diktaturës dhe artit është shtruar shpesh herë nga Ismail Kadare. Nëse para vitit 1990 nënkuptimi ka qenë shtresa e parë që duhej hequr, më pas, është bërë qasje e domosdoshme e pandryshueshme dhe e kuptueshme njëkohësisht. Një qasje e tillë ka qenë e domosdoshme për shkak të shtresimeve të krijuara.

Pikëpyetja e njerëzimit ka qenë në dilemën e përzgjedhjes, mes hekurit të rëndë të shpatës së pushtetit apo poezisë, për të cilën kemi përkufizimin magjik të Platonit, "kjo gjë e lehtë, flatrore dhe e shenjtë".

(Vijon në numrin e ardhshëm)

E rrallë

Burri që nuk lahet dhe pret flokët prej 40 vjetësh

Sakal Dev Tuddu nga Munger i mban flokët sipër kokës në formën e një çallme. Ky burrë nuk i ka larë dhe prerë flokët e tij prej 40 vitesh. Ai vendosi dy vjet më parë që flokët e tij të mos i priste dhe lante më. 63-vjeçari u shpreh se Perëndia e vizitoi në



ëndërr dhe i tha që të mos priste flokët, një udhëzim që e respektoi nga ajo kohë.

BARSOLETA E DITËS



Sa herë që shkoj në restorant e lexoj menynë sikurse lexojnë arabët, prej anës së djathtë në të majtë. Fillimisht çmimin, pastaj ushqimin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray




Ne ora 22:00

“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një kujdestar elefantësh në Myanmar shihet duke e ushqyer me banane një elefant. /AP/

E jashtëzakonshme

Gjashtëvjeçari bën 3 270 pompa

Një djalë rus gjashtëvjeçar ka bërë atë që edhe një ekspert palestre mund ta ëndërrtojë. Ibrahim Lyanov nga rajoni Novy Redant theu rekordin botëror duke bërë 3 270 pompa vetëm për dy orë. Ai fitoi një apartament për familjen e tij si dhe hyri në Librin e Rekordeve Ruse.



| | | | | | |
|--|---|---|--|--|---|
|  <p>DASHI Është shumë e thjeshtë t'i shtyni gjithmonë gjërat për nesër, por sot nëse nuk doni të impenjoheni me një person duhet t'ia thoni.</p> |  <p>DEMI Gjeni kurajën dhe hiqni dorë nga një situatë që nuk po e mbështetni më. Megjithëse do të thotë shumë për ju, duhet ta merrni si vendim.</p> |  <p>BINJAKËT Nuk keni pse të mërzhiteni nëse gjërat kanë marrë një rrjedhë të caktuar. Keni qenë ju vetë që jeni bërë shkak për këtë rezultat.</p> |  <p>GAFORRJA Sot do ta keni të vështirë të merrni një vendim. E dini që shumë nga personat që keni pranë do të preken nga kjo gjë.</p> |  <p>LUANI Nëse e dini që një kolegu juaj merret shumë me llafe, nuk keni pse i tregoni rreth projektit tuaj, pasi ai do të marrë të gjithë meritën.</p> |  <p>VIRGJËRËSHA Në fushën profesionale s'po ndiheni shumë mirë sot. Për këtë arsye keni dyshime të forta të mbyllni marrëveshje dhe kontrata me persona të tjerë.</p> |
|  <p>PESHORJA Duhet të eliminoni çdo formë stresi në ditët në vijim. Nëse ende nuk keni vendosur për të ndërmarrë një veprim, sot është dita.</p> |  <p>AKREPI Sot do të jetë një ditë relaksimi që keni dëshirë ta kaloni sa më larg ambientit të punës. Një piknik ose një shëtitje në plazh janë ato që po kërkon.</p> |  <p>SHIGJETARI Nëse sot nuk doni të jeni shumë i zënë me punë, bëni mirë të mos lini takime ose orare të reja. Mund të keni përplasje takimesh.</p> |  <p>BRICJAPI Sot do t'ju plotësohet çdo kërkesë. Duhet të jeni mirënjohës ndaj një eprori ose të afërmi tuaj që ju kanë kaq përzemërt.</p> |  <p>UJORI Sot duhet të arrini një qëllim të caktuar edhe nëse do t'ju duhet të bashkëpunoni me armiqtë tuaj. Siç thuhet, çdo qëllim justifikon mjetin.</p> |  <p>PESHQIT Nëse keni parë që persona të caktuar nuk kanë shumë simpati për ju, sot duhet të bëni të mundur që ky opinion të ndryshojë.</p> |



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Rexha: Në Ligën e Evropës do të marrim rezultate më të mira

Ish-sulmuesi i shumë skuadrave në Kosovë, Kastriot Rexha, e ka vlerësuar të pamerituar eliminimin e Feronikelit nga Liga e Kampionëve, por ka paralajmëruar rezultate më të mira në Ligën e Evropës. "Në Ligën e Evropës do të bëjmë lojërë të mira sikurse në Ligën e Kampionëve, por besoj se do të marrim edhe rezultate më të mira", ka thënë Rexha



Sulmuesi shtatlartë ishte "hero" i Feronikelit në rrugëtimin drejt titullit kampion dhe triumfit në garën e Kupës, por edhe në ndeshjen ndaj Lincolnit, pasi shënoi golin e kualifikimit në rrethin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 KORRIK - Sulmuesi Kastriot Rexha të mërkurën për "Epokën e re" ka thënë se Feronikeli është eliminuar nga Liga e Kampionëve pasi nuk kishte fat në finalizimin e aksioneve. "Nikli" dështoi ta shkruajë historinë e futbollit të Kosovës në Ligën e Kampionëve, duke u bërë skuadra e parë që kualifikohet në rrethin e dytë të kësaj gare, pasi të martën pësoi humbje në stadiumin "Fadil Vokrri" nga TNS-ja (0-1). "Jemi eliminuar nga TNS-ja edhe përkundër një paraqitje të mirë që kemi pasur gjatë gjithë ndeshjes, por

edhe fati nuk ishte në anën tonë në këtë ndeshje shumë të rëndësishme. Kemi pasur mundësi t'i përfundojmë më mirë aksionet e shumta që krijuam, por na mungoi fati. Megjithatë, edhe përkundër eliminimit, mund të jemi të kënaqur me atë që kemi treguar në dy ndeshjet", ka thënë Rexha, i cili ka treguar edhe për reagimin e trajnerit dhe drejtorit të klubit pas humbjes që u kushtoi me eliminim kampionëve të Kosovës. "Trajneri na ka përgëzuar për angazhimin dhe shpirtin luftarak që kemi pasur si ekip, por edhe drejtori Malsor Gjonbalaj pati fjalë të mira për skuadrën lidhur me atë që tregoi gjatë 90 minutave", ka shtuar ai.

Rexha është aktualisht sulmuesi më i mirë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll dhe ishte shpresa më e madhe e skuadrës nga Drenasi në ndeshjen ndaj kampionëve të Uellsit, por dështoi të shënojë ashtu sikurse që dështuan edhe bashkëlojtarët e tij. "Kemi pasur topa mjaftueshëm në zonën e rrezikshme, por mendoj se nuk kam arritur të gjendem në çastin e duhur dhe vendin e duhur, prandaj kjo është arsye pse nuk kam shënuar në këtë ndeshje", ka

deklaruar sulmuesi shtatlartë. Eliminimi nga Liga e Kampionëve nuk e nxjerrë jashtë garave evropiane skuadrën kampionë dhe fituese të Kupës në Kosovë, pasi "Nikli" do të bëjë gara në rrethin e dytë të Ligës së Evropës. Rexha paralajmëron paraqitje të mira edhe në këtë garë dhe rezultate më të mëdha. "Në Ligën e Evropës do të bëjmë lojërë të mira sikurse në Ligën e Kampionëve, por besoj se do të marrim edhe rezultate më të mira", ka thënë Rexha.

Ramiz Lladrovci: Krenar me futbollistët tanë

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka reaguar pas eliminimit të Feronikelit nga Liga e Kampionëve. "Kemi mundur më mirë, nuk ishte mbrëmje jona. Ka munguar vetëbesimi për fitore. Feronikeli e hapi shtegun për suksese të tjera, për suksese edhe më të mëdha të futbollit tonë. Krenar me futbollistët tanë!", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

Trajneri me përvojë ndërkombëtare stërvit gjimnastet e 'Elitës'



PRISHTINË, 17 KORRIK - Prej dy javësh sportistët e Klubit të Gjmnastikës "Elita" janë stërvitur nga trajneri i gjmnastikës Muhamed Muharremi, i cili prej vitesh ushtron dhe stërvit sportistët në Norvegji. Trajneri Muharremi ka një karrierë të gjatë sportive në gjmnastikë në disiplinën tumbling, në akro (akrobatic) dhe në cheerleader, ku triumfet e tij janë të shumta, duke nisur që nga pjesëmarrja në kampi-

onate botërore, duke përfaqësuar ekipin norvegjez. Në vitin 2013 ai është shpallur kampion i Norvegjisë dhe përsëri në po të njëjtin vit e ka fituar vendin e dytë në Kampionatin Evropian, ku për pesë poenë mund të ishte shpallur edhe kampion evropian. "Gjatë proceseve stërvitore Muhamedi ishte i pakursyer në punën e tij si trajner, duke bërë që gjmnastet tona të ndihen rehat, të motivohen dhe të për-

mirësohen në pjesën teknike të ushtrimeve", thuhet në njoftimin e KGJ "Elita". Në shenjë falënderimi për energjinë dhe punën e pakursyer Klubi i Gjmnastikës "Elita" i ndau mirënjohje, kurse kryetrajneri i klubit, Shkumbin Maqestena, e falënderoi për zëmërisht për ardhjen e tij në klubin prishtinas, duke konfirmuar se dyert e "Elitës" gjithmonë janë të hapura për të.

Golfi i Kosovës pranohet ndërkombëtarisht

PRISHTINË, 17 KORRIK - Federata e Golfit e Kosovës është pranuar në Federatën Ndërkombëtare të Golfit. Këtë lajm e ka konfirmuar sekretari i përgjithshëm i FGK-së, Lavdim Zylfiu. "Presidenti i IPPA (International Pitch and Putt Association), Carlo Farioli, i cili në diskutim me Bordin e IPPA ka shqyrtuar kërkesën e Federatës së Golfit të Kosovës për t'u bërë anëtare

në këtë organizatë dhe tani e tutje jemi anëtarë më i ri i kësaj organizate sportive të lojës së golfit. Bordi i IPPA-s është i impresionuar me fondin e lojtarëve që ka në dispozicion Federata e Golfit e Kosovës dhe në mënyrë urgjente i është përgjigjur kërkesës sonë me konsideratën më të lartë", ka thënë Zylfiu. "Anëtarësimi në këtë organizatë hap dyert e pjesëmarrjes së golfistëve nga

Kosova në garat të cilat i organizon IPPA në 28 shtete të botës, gjithashtu i hap rrugën Federatës sonë për t'u anëtarësuar në EGA (European Golf Association) si organizata më e lartë e golfit në botë, sepse me automatizëm do të bëhemi edhe anëtar në R&A", ka shtuar ai. Federata e Golfit e Kosovës aktualisht ka në dispozicion mbi 30 lojtarë të golfit, prej tyre katër lojtarë profe-



sionalë dhe kjo e bën FGK-në si njëri prej federatave më të fuqishme në rajon. Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së Golfit ka njoftuar se në ditët e

ardhshme do të zhvillohet një takim me ministrin e MKRS-së, Kujtim Gashi, për ta informuar hollësisht rreth objektivit të FGK-së.

Alidema prezantohet te Slaven Belupo

KOPRIVNICA, 17 KORRIK - Ish-futbollisti i Vllaznisë së Pozharanit dhe Llapit, Festim Alidema, është prezantuar si lojtar i ri në skuadrën kroate, Slaven Belupo. Ai e ka falënderuar zotin, familjen, trajnerët, bashkëlojtarët dhe gjithë ata që e përkrahen në rrugëtimin e tij si futbollist. "E falënderoj zotin që ma dhënë këtë mundësi të

luaj në Evropë. Faleminderit familjes që më ka motivuar dhe më ka dhënë vullnet të madh, të cilët i dua shumë dhe të gjithë ata që më kanë përkrahur dhe që vazhdojnë të më përkrahin gjithmonë. Dua t'i falënderoj agjencinë 'Soccer 11' (Adrian Alia, Arbër Abilaliaj, Genc Hyseni etj). Po ashtu, dua t'i falënderoj të gjithë

trajnerët që pa ta nuk do të isha këtu ku jam (Tahir Batatina, Bylbyl Sokoli, Bekim Isufi, Bekim Shotani, Xhengiz Rexhepi) dhe të gjithë bashkëlojtarët", ka thënë Alidema, i cili në sezonin e fundit ka zhvilluar 29 ndeshje me Llapin në IPKO Superligë, teksa ka edhe një paraqitje në Kupë, ku numëron 12 gola dhe 6 asistime.



Berisha: Kemi shanse për kualifikim

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kosova po vazhdon stërvitjet dy herë në ditë për t'u përgatitur sa më mirë para ndeshjeve parakualifikuese për "Eurobasket 2021". "Dardanët" po stërvitin anën fizike dhe taktike, derisa atmosfera në kampin e Kosovës është shumë e mirë.

Përzgjedhësi i Kosovës, Damir Mulaomerović, ka kërkuar angazhim nga lojtarët edhe në stërvitje, duke theksuar se përballjet nuk do të jenë aspak të lehta dhe njëkohësisht shumë të rëndësishme. Kosova gjatë gushtit do të përballet me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe (ndeshje vajtje-ardhje), ku vendi i parë kualifikohet tutje.

Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Stërvitjet po shkojnë shumë mirë. Ne do të mundohemi të përgatitemi maksimalisht deri para ndeshjeve në muajin gusht. Gjithashtu, do të kemi edhe ndeshje miqësore që do të na ndihmojnë shumë. Shpresoj të mos kemi lëndime deri në fund dhe gjithçka të shkojë sipas planit", ka thënë Berisha për faqen zyrtare të FBK-së.

Ai foli edhe për gjasat e Kosovës për kualifikim. "Sa kanë gjasat



kundërshtarët tanë, ashtu edhe ne kemi gjasat. Ne do të mundohemi të bëjmë paraqitje sa më të mirë. Por, shpresoj se me ndihmën e publikut do t'ia dalim. Ndeshja e parë është shumë e rëndësishme dhe do të mundohemi të fitojmë. Sidoqoftë, angazhimi ynë nuk do të

mungojë dhe do të japim 100% nga vetja", ka shtuar Berisha. "Dardanët" më 3 gusht janë mysafirë të Luksemburgut, më pas e presin Britaninë e Madhe më 7 gusht dhe Luksemburgun më 14 gusht, kurse ndeshja e fundit është kundër Britanisë në udhëtim më 17 gusht.

Halep, bartëse e flamurit në 'Tokio 2020'

